

## *Çfarë do të bëni me Jezusin?*

---

Pavarësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i botës ku jetojmë, sipas Shkrimeve të Shenjta, ajo (bota) është vetëm një vend i përgatitjes për jetën që do të kemi në përjetësi. Pra, jeta këtu është vetëm një fillim i shkurtër. Çdo qenie njerëzore është një shpirt i gjallë, i caktuar të jetojë përtej kësaj bote në qiell ose në ferr. Testamenti e Ri përshkruan jetën e përjetshme dhe shkatërrimin e përjetshëm (Mateu 25:46). Testamenti i Ri tregon se nuk ka ndonjë vend të ndërmjetëm për të qëndruar midis këtyre dy vendeve. Pas vdekjes apo në momentin që Jezusi do të kthehet, të gjithë njerëzit, të gjallët dhe të vdekurit, do të hyjnë në vendet e tyre të përjetshme dhe do të jetojnë atje përjetësisht. Kjo është me të vërtetë serioze! Vendi që i japim Jezusit në jetën tonë, përcakton se ku do ta kalojmë përjetësinë. Lutemi që ta merrni vendimin për t'u bërë kristianë dhe të jetoni për Krishtin. Kështu ju mund të keni jetë me shumicë tani (Gjoni 10:10) dhe jetën e përjetshme në botën që do të vijë (1 Gjon 2:25).

Keni arritur në fund të studimit për t'u bërë një anëtar besnik i «kishës», i asaj kishe që është paraqitur në Shkrimet. Jeni prezantuar shkurtimisht me Jezu Krishtin, Birin e

Perëndisë, i cili erdhi në botë dhe demonstroi me anë të jetës, mësimëve dhe dashurisë së Tij natyrën e Perëndisë dhe vullnetin e Tij. Ai vdiq në kryq për mëkatet tona, duke bërë të mundur për çdo njeri që i bindet mesazhit të Tij të shpëtimit të bëhet fëmijë i Perëndisë dhe të jetojë si i tillë. Më tej, ju keni studiuar me kujdes natyrën e kishës që u krijua dhe vazhdon të ekzistojë si rezultat i jetës dhe vdekjes së Jezusit. Ju keni parë se si një njeri hyn në kishë dhe jeton në këtë botë si anëtar i saj. Tani ju keni arritur te pyetja e madhe, pyetja më e rëndësishme që mund t' i bëni vetes: «Çfarë duhet të bëj me Jezusin?»

Është lutja e sinqertë dhe shpresa e madhe e gjithë kristianëve që ju të vendosni në zemrën tuaj të bëheni kristian dhe një ndjekës besnik i Krishtit për gjithë jetën tuaj. Gjatë studimit të këtyre faqeve, ndoshta ju tashmë keni thënë: «Unë dua të bëhem kristian.» Ndoshta ju keni menduar: «Unë kam disa pyetje përpara se të bëhem kristian dhe, kur të marr përgjigjet e atyre pyetjeve, do të vendos.»

Në qoftë se ju po bëni pyetje, lexoni me kujdes pjesën që ka mbetur nga ky libër. Kjo pjesë do t'ju japë disa përgjigje. Gjithashtu, kjo pjesë rreshton dhe shpjegon disa hapa që ju keni nevojë t' i merrni, me qëllim që të përmbushni dëshirën tuaj për t' u bërë kristian dhe për të jetuar si i tillë.

## HAPI I PARË: SHPËTIMI

Duhet të bëheni kristianë! Ky është hapi i parë që duhet të hidhni. Çdo njeri, në çdo vend të botës, mund të bëhet kristian, në qoftë se beson në Krisht (Gjoni 8:24), pendohet (apo kthehet nga mëkatet e tij; Veprat 17:30), pranon Jezusin si Birin e Perëndisë (Romakëve 10:10) dhe pagëzohet në Krisht për faljen e mëkateve (Veprat 2:38).

### «Po për fëmijët?»

Testamenti i Ri kurrë nuk përmend pagëzimin e fëmijëve apo foshnjave. Ata nuk kanë nevojë të pagëzohen, sepse ata

janë të siguruar në pafajësinë e tyre përpara Perëndisë. Ata nuk dinë të dallojnë të mirën nga e keqja dhe, si rrjedhim, nuk janë të përgjegjshëm përpara Perëndisë. Kur bëhen të ndërgjegjshëm për atë që u kërkohet nga Perëndia, atëhere ata duhet të bëhen kristianë (si të gjithë njerëzit) duke ndjekur rrugën e shpëtimit të përcaktuar nga Perëndia. Sidoqoftë, me pafajësinë e tyre ata janë të mbrojtur përpara Perëndisë, sepse ata nuk kanë mëkatuar. Me mendjet e tyre të vogla, ata kërkojnë të kuptojnë më shumë, duke e vendosur besimin e tyre tërësisht në ata që i udhëheqin. Besimi i tyre i plotë dhe etja për të mësuar shpejt është një shembull i mirë që duhet imituar nga të rriturit (Mateu 18:3). Jezusi tha për fëmijët: «Sepse atyre u përket mbretëria e qiellit» (Mateu 19:14b).

Por, situata ndryshon për ne, të rriturit. Duke qenë se e kuptoni rrugën e shpëtimit, se e dini që keni mëkatuar përpara Perëndisë dhe se duhet të bëheni kristian për t'u shpëtuar, ju duhet t'i bindeni planit të Perëndisë për shpëtim tani.

### «Çfarë duhet të bëj?»

Në studimet tona ju keni parë se si mund të bëheni kristianë. Ju mund të bëheni kristianë duke pranuar evidencën dhe dëshminë e Shkrimeve për Jezusin, Birin e Perëndisë. I vetmi libër i saktë në botë ju tregoi se kush ishte Jezusi dhe përse erdhi në këtë botë. A e pranoni këtë mesazh? Në qoftë se e pranoni, atëhere besoni se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë i cili erdhi në botë për të vdekur në kryq që t'ju shpëtonte nga mëkatet tuaja dhe të bënte të mundur që të jeni fëmijë të Perëndisë.

Ju duhet të pyesni veten: «A jam larguar nga mëkatet e mia?» Kurrë nuk mund të jeni të përkryer në këtë botë, por me anë të pendimit ju vendosni të largoni mëkatin nga jeta juaj dhe me sinqeritet të ndiqni Fjalën e Perëndisë nga ky moment dhe në vazhdim të jetës suaj. Pas pendimit, Jezusi

do të jetë Zoti juaj dhe Shkrimet do të jenë udhëzuesit me anë të të cilëve do të jetoni.

Veprimi tjetër është të gjeni dikë që t'ju pagëzojë në Krisht për faljen e mëkateve tuaja. Ndoshta gjendet një kishë e Krishtit në komunitetin tuaj (vendin ku jetoni). Në qoftë se është e mundur, gjeni një anëtar të kishës dhe kërkoni që t'ju prezantojë me një burrë kristian, i cili mund t'ju pagëzojë në Krisht. Kur të prezantoheni me atë vëlla në Krisht, tregojini se doni ta pranoni Jezusin si Krisht përpara të tjerëve dhe se dëshironi që ai t'ju pagëzojë në trupin shpirtëror të Krishtit për faljen e mëkateve tuaja. Ai do të jetë i gëzuar që t'ju ndimojë.

### **«Si mund ta gjej kishën e Krishtit?»**

Në kohët e sotme kur njerëzit përballen me kisha dhe besime të ndryshme, ju duhet të siguroheni se keni takuar një grup njerëzish që kanë hyrë në kishën e Perëndisë dhe vazhdojnë të jenë kisha e Perëndisë. Për t'u siguruar se grupi që po shqyrtoni është kisha e Perëndisë, shikoni emrin me të cilin ata thërrasin veten e tyre. Nëse janë kisha e Perëndisë, Ata nuk do të mbajnë ndonjë emër të bërë nga njerëzit. Ata do ta quajnë veten kisha e Krishtit dhe do t'i referohen vetes me anë të emrave të tjerë për kishën të gjetur në Shkrimet (Bibël). Në qoftë se shikoni se ata i kanë dhënë vetes një emër që nuk është nga Bibla për të emëruar kishën e tyre, kjo është shenjë se ata janë pjesë e një grupi fetar dhe si rrjedhim janë të ndarë dhe të ndryshëm nga kisha e Perëndisë.

Një mënyrë tjetër me anë të së cilës mund të dalloni në se një grup është Kishë e Krishtit, është të verifikoni nëse ata ndjekin Fjalën e Perëndisë. Këtu janë disa pyetje që mund t'u bëni atyre për të kuptuar synimet dhe qëllimet e tyre:

A po përpiqeni që të jeni thjesht kisha e Testamentit të Ri?

Kur mblidheni të dielave për adhurim, si është shërbesa juaj?

A e merrni Darkën e Zotit ditën e parë të çdo jave<sup>1</sup> (çdo të dielë), si te Veprat 20:7?

A këndon pa instrumenta muzikorë sipas shembullit të Testamentit të Ri?

A luteni në emër të Jezusit?

A e studioni Biblën si të vetmin dokument të besimit tuaj dhe si udhëzuesin tuaj të vetëm?

A jepni çdo të diel, sipas atyre që keni fituar me punën tuaj (1 Korintasve 16:1–2)?

Si është e organizuar kisha juaj? A janë predikuesit, mësuesit, më të vjetrit dhe dhjakët të vetmit njerëz që kanë autoritet mbi kishën tuaj?<sup>2</sup>

A keni qendra drejtuese tokësore apo thjesht shikoni Krishtin si kreun tuaj?<sup>3</sup>

Cili është misioni juaj në këtë botë: A po përpiqeni që të përmbushni Urdhëresën e Madhe të Zotit (Mateu 28:19–20)?

Ju do të përfitoni, po të bënit këto pyetje, sepse po kërkonit të kuptoni se kush janë ata. Mbani mend, ju doni të bëheni anëtarë të kishës së Perëndisë dhe jo anëtarë të ndonjë ndarjeje fetare. (Shikoni tabelën e titulluar «Si të organizojmë një bashkësi të re duke ndjekur mësimet e Biblës» në mësimin “Shtojca 2”.)

Në qoftë se s’do të mund të gjeni një kishë të Krishtit në vendin ku jetoni, atëhere ju duhet të themeloni një kishë të tillë. Kjo është mënyra si të veproni. Gjeni një njeri të sinqertë i cili është i interesuar për t’i shërbyer Perëndisë së vërtetë. Kërkojini atij që të lexojë këtë libër, ndërsa studion Biblën e tij. Pastaj pyete në qoftë se ai do të bashkohet me ju duke u bërë kristian për t’u bërë kisha e Perëndisë në vendin ku jetoni. Në qoftë se ai do të ndjekë Krishtin, ju mund ta pagëzoni atë dhe ai mund t’ju pagëzojë juve. Ju do të keni nevojë të shkoni pranë një rrjedhe, një liqeni apo pishine ku të ketë ujë të mjaftueshëm për të zhytur dikë.

Kur ta pagëzoni, sigurohuni të përmbushni tre urdhëresat

e Shkrimeve. Së pari, bëji atij këtë pyetje: «A besoni se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë?» Ne e gjejmë këtë urdhëresë te Romakëve 10:10. Ai duhet të pohojë se beson se Jezusi është Biri i Perëndisë.

Së dyti, duhet të siguroheni se po e pagëzoni atë në trupin e Krishtit, në kishën, për faljen e mëkateve. Si rrjedhim, përpara se ta pagëzoni, shpjegojini qartësisht se çfarë po ndodh, për përfitimin e atyre që mund të jenë të pranishëm dhe për t'i kujtuar atij çfarë po ndodh. Këtu është një shembull se si mund ta formuloni thënien tuaj (bazuar te Mateu 28:19–20; Romakëve 6:3; Veprave 2:38 dhe Marku 16:16):

Unë të pagëzoj në emër të Atit, të Birit dhe të Frymës së Shenjtë, në trupin shpirtëror të Krishtit, kishën e Testamentit të Ri, për faljen e mëkateve të tua përmes gjakut të Jezu Krishtit, në përputhje me urdhëresën e Krishtit.

Së treti, kur ta pagëzoni, sigurohuni ta zhysni tërësisht. Mbani mend se pagëzimi në Testamentin e Ri është një varrosje në ujë (Romakëve 6:4). Këtu kemi disa ilustrime për kryerjen e pagëzimit.



*Në ujë të cekët, ai që pagëzohet mund të ulet dhe të përkulë trupin mbrapa, derisa të jetë tërësisht i mbuluar me ujë.*



*Në një vend që ka ujë të bollshëm, ai që pagëzohet mund të përkulet mbrapa në ujë, derisa të zhytet plotësisht.*

Pasi ta keni pagëzuar, kërkoni atij t'ju pagëzojë në të njëjtën mënyrë. Ai duhet t'ju bëjë të njëjtat pyetje dhe

duhet ta thotë qartë pse po ju pagëzon, ashtu si bëtë edhe ju me të.

Tani, supozoni se ju gjeni një burrë të mirë, dhe i jepni këtë libër për ta lexuar. Por, kur mbaron së lexuari, ai nuk do që të bëhet kristian. Çfarë mund të bëni atëhere? Shkoni dhe pyeteni, në se është i gatshëm t'ju pagëzojë juve. Ka shumë mundësi që ai do të dojë të bëhet kristian gjithashtu. Por, në qoftë se nuk pranon, ndoshta ti mund t'i kërkosh të të pagëzojë në mënyrën e treguar më lart. Në qoftë se ai nuk është i gatshëm të të pagëzojë, gjej një burrë tjetër të mirë që është i gatshëm. E vërteta e rëndësishme për t'u mbajtur mend është se kushdo që ju pagëzon, duhet ta bëjë atë sipas mësimëve të gjendura në Shkrimet. Mos lejo askënd, kushdo që ai të jetë, të anashkalojë qoftë edhe një urdhër të vetëm të Shkrimeve.

Pas pagëzimit, jeni kristian, një anëtar i kishës së Perëndisë. Edhe në qoftë se kisha e Perëndisë nuk ka ekzistuar në komunitetin tuaj në të kaluarën, atëhere ajo fillon të ekzistojë tani, sepse ju vetë jeni kisha e Krishtit! Ju e keni themeluar kishën e Krishtit në vendin ku jetoni duke u bërë kristian.

## **HAPI I DYTË: TË JETUARIT SI KRISTIAN**

Natyrisht, hapi i dytë që keni nevojë të bëni, është një hap i vazhdueshëm dhe i pandalshëm, pra, hapi i të jetuarit si kristian. Ju jeni tashmë një kristian dhe duhet të jetoni si i tillë. (Shikoni tabelën e titulluar «Cilësitë e të vjetërve duhet t'i kenë gjithë kristianët e tjerë» në mësimin “Shtojca 2”.)

Si jeton një kristian? Një mënyrë e mirë për të përshkruar jetën e një kristiani është të reflektosh rreth emrit që mban: një ndjekës i Krishtit. Ai është një kristian, që jeton ashtu si jetoj Krishti (Filipianëve 1:21). Jeta për kristianin është Krishti.

### **Duke kërkuar Shkrimet**

Çdo njeri që ndjek Krishtin, karakterizohet nga një tipar i veçantë: nënshtrimi ndaj vullnetit të Atit. Jezusi ishte i përkryer në çdo aspekt dhe një karakteristikë e jetës së Tij, e cila duhet të na karakterizojë edhe ne, ishte bindja e plotë ndaj Atit. Atëherë, jetesa kristiane nënkupton kërkimin e Shkrimeve për të njohur vullnetin e Perëndisë dhe pastaj bindje ndaj atij vullneti me përlujtje dhe dashuri. Kristiani e mban afër Fjalën e Perëndisë. Ai e lexon atë përditë dhe përpiket të vërë në praktikë atë që mëson prej saj.

### **Duke u përpjekur të jetojmë sipas shembullit të Jezusit**

Tre parime të tjera që duhet të na udhëheqin në jetën tonë dedikuar Jezusit, përfshijnë «rregullën e artë», dhembshurinë dhe lutjen. Një mënyrë e mirë për të imituar Jezusin është të pyesim veten gjithmonë: «Si do të më pëlqente të më trajtonin të tjerët?» «Rregulli i artë» (Mateu 7:12) zbatohet kur i trajtojmë të tjerët në të njëjtën mënyrë që do të donim të na trajtonin ata ne. Ky rregull ishte mënyra e jetesës së Krishtit dhe është rruga më e mirë për të jetuar në këtë botë.

Jezusi ishte një njeri i dhembshur. Fjala «dhembshuri» do të thotë «të jetosh me hallet dhe problemet e të tjerëve». Jezusi i donte të varfërit, nevojtarët dhe të vetmuarit. Zemra e Tij ishte me ta. Ai u kujdes për çdo aspekt të jetës së tyre. Pra, kristiani duhet të shqetësohet për të tjerët dhe vazhdimisht ta manifestojë dashurinë duke i ndihmuar ata me të gjitha mundësitë e veta (Mateu 9:36).

Edhe pse Jezusi ishte Biri i Perëndisë, Ai i lutej shpesh Atit. Ai u lut privatisht, publikisht apo në prani të një grupi të vogël njerëzish. Kristiani, gjithashtu, i lutet Perëndisë, krijuesit të tij, në mënyrë të vazhdueshme.

Meqënëse tani jeni kristianë, Perëndia është Ati juaj. Ai ju ka bërë të Tijin. Lutjuni Atij rregullisht me një zemër



të mbushur me besim. Kërkojini që dëshira e Tij të bëhet në jetën tuaj, duke iu lutur në emrin e Jezusit. Këtu është një shembull se si mund t'i luteni Perëndisë:

*Drejtojuni Perëndisë: At i Dashur,*

*Lëvdoheni Atë: U shenjtëroftë emri Yt.*

*Falenderoheni Atë: Sa mirënjohës jemi për bekimet që na ke dhënë... (rreshtoni disa nga ato).*

*Kërkojini Atij: Këto janë nevojat tona (bëjini të njohura gjithë nevojat tuaja), si i mendojmë ne. Na i plotëso ato, në qoftë se janë në harmoni me vullnetin Tënd.*

*Kërkojini Atij: Na fal nga mëkatet siç falim të tjerët. Na shpëto nga e keqja.*

*Lëvdoheni Atë: Gjithë lavdia qoftë Jotja.*

*Mbyllja: Në emër të Jezusit të lutemi. Amen.*

Ju ndoshta shikoni në këtë lutje modelin e lutjes që Zoti ynë u mësoi dishepujve të Tij te Mateu 6:9–13. Një pjesë e lutjes së Tij nuk mund të aplikohet për ne (për shembull, pjesa e kërkesës për ardhjen e mbretërisë, meqënëse mbretëria e Tij erdhi në ditën e Rrëshajëve), por pjesa tjetër e lutjes aplikohet për ne sot. Mbani mend se modeli që u dha është vetëm një shembull dhe ka për qëllim të jetë një rregull për t'u ndjekur kur dikush i lutet Perëndisë.

Le të bëjmë një listë të parimeve që kemi parë për jetesën kristiane:

Përpjekja për të jetuar ashtu si jetoi Krishti.

Studimi me kujdes i Fjalës së Perëndisë dhe bindja ndaj asaj që mësojmë.

Të paturit e një shpirti të bindur ndaj Atit

Trajtimi i të tjerëve si do donim të trajtoheshim prej tyre.

Demonstrimi i dhembshurisë për njerëzit nevojtarë rreth nesh.

T'i lutemi Atit përmes Jezusit.

Korrigjimi me kujdes i gabimeve tona, sapo i bëjmë ato.

Le të theksojmë këtë të vërtetë: Nuk mund të jemi të përkryer. Krijesat njerëzore nuk mund të jenë të përkryera,

por mund t'ia dedikojmë zemrat tona zbatimit të vullnetit të Tij. Kur dështojmë, mund të ngrihemi përsëri, të shkundim veten dhe të fillojmë përsëri të bëjmë vullnetin e Perëndisë. Gjëja e rëndësishme është të përpiqemi, me gjithë mundësitë dhe aftësitë tona, të bëjmë vullnetin e Tij. Shpëtimi ynë vjen nga hiri i Perëndisë, nëpërmjet besimit tonë dhe jo me anë të përsosmërisë sonë në zbatimin e ligjit të Perëndisë (Romakëve 1:17; Efesianëve 2:8). Nga ana tjetër, besimi i vërtetë e shtyn besimtarin të kërkojë me ngulm zbatimin e vullnetit të Perëndisë (Jakobi 2:24).

Kur, me anë të veprimeve tona të gabuara, dëmtojmë të tjerët, le t'u kërkojmë falje dhe t'i sigurojmë ata se na vjen keq dhe se do të përpiqemi të mos e bëjmë të njëjtën gjë në të ardhmen (Jakobi 5:16). Në qoftë se mëkatojmë dhe mëkati ynë dëmton gjithë kishën, mund të dalim përpara kishës, të kërkojmë falje dhe t'u kërkojmë vëllezërve dhe motrave tona në Krisht të lutën për ne (Jakobi 5:16). Perëndia do të na falë dhe kisha gjithashtu.

Një pjesë e Shkrimeve, që do t'ju ndihmojë shumë, *kur* të filloni jetën si kristianë, është fillimi i Testamentit të Ri. Dua të them katër ungjijtë (sipas Mateut, Markut, Llukës dhe Gjonit), të cilët përshkruajnë jetën e Krishtit në tokë. Leximi dhe studimi i tyre do t'ju njohë me jetën e Jezusit në tokë. Çdo gjë që mësoni për Të, do t'ju ndihmojë që ta ndiqni Atë më nga afër.

### **HAPI I TRETË: ADHURIMI I PERËNDISË**

Hapi i tretë që duhet të bëni për t'u bërë apo për të qenë kristianë, është të filloni adhurimin e Perëndisë rregullisht.

Në qoftë se një kishë e Krishtit ekziston afër shtëpisë suaj, duhet të takoheni me ta të dielën dhe çdo herë tjetër që ata takohen për të adhuruar Perëndinë së bashku. Çdo të diel, ata do të takohen për të kënduar, për t'u lutur, për të studiuar Fjalën e Perëndisë, për të marrë Darkën e Zotit dhe për të kontribuar financiarisht në përputhje me bekimet

materiale që Perëndia u ka dhënë gjatë javës. Duhet të bashkoheni me ta, sa herë që ata mblidhen për të adhuruar Perëndinë.

Në qoftë se asnjë kishë e Krishtit nuk ekziston në komunitetin tuaj (afër vendbanimit tuaj) përveç jush, mund të filloni ta adhuron Perëndinë rregullisht dhe besnikërisht në shtëpinë tuaj, në ndonjë dhomë të marrë me qera apo qoftë edhe në natyrë të hapur. Me kalimin e kohës, mund të ndërtoni një vend ku mund të adhuron Perëndinë. Testamenti i Ri thotë se nderimi sipas Biblës mund të bëhet kudo që dy apo tre njerëz janë mbledhur në emrin e Jezusit (Mateu 18:20).

### **Takimi si kishë**

Në Testamentin i Ri vërejmë se kristianët e hershëm takoheshin në ditën e parë të javës, të dielën. (Sipas Biblës, kjo është dita e parë e javës.) Siç e dini, kjo është dita kur Krishti u ngrit nga vdekja. Sa herë që mblidheshin së bashku për të adhuruar Perëndinë, kristianët e parë merrnin darkën që Zoti e krijoi për të na ndihmuar të kujtojmë vdekjen dhe ringjalljen e Tij. Nga studimi i Biblës duket qartë se ata merrnin pjesë në Darkën e Zotit çdo të diel. Ajo ishte «Darka e Zotit» (1 Korintasve 11:20), e marrë në çdo Ditë të Zotit. Studioni Hebrenjve 10:25; 1 Korintasve 11:22, 16:1–2 dhe Veprat 20:7.

### **Marrja e Darkës së Zotit**

Kur Krishti krijoi Darkën e Zotit, Ai përdori dy elementë: frutin e vreshtit dhe bukën e paardhur. Jezusi po festonte darkën e Pashkës me dishepujt e Tij, kur i urdhëroi ata që ta merrnin këtë Darkë në të ardhmen, në përkujtim të Tij. Darka e Pashkës përfshinte vetëm bukë të paardhur dhe pije, që vinte nga fruti i vreshtit. Jezusi u tha dishepujve të Tij që, kur të marrin bukën, të kujtojnë trupin e Tij, që u sakrifikua për ta. Ai u tha të pinin pak nga kupa, nga fruti

i vreshtit, dhe të kujtonin gjakun e Tij, i derdhur për faljen e mëkateve të tyre në kryq.

Ju duhet të ndiqni udhëzimet e Zotit tonë dhe shembullin e kristianëve të parë në librin e Veprave. Çdo të diel, duke iu bindur mësimëve të Zotit tonë, Krishtit, duhet të mblidheni për nderim në ndonjë vend të caktuar. Këndoni, lutuni dhe studioni Fjalën e Perëndisë. Në një moment, gjatë kohës së adhurimit, merreni këtë darkë që Jezusi vetë e krijoi. Vendoseni bukën e paardhur në një pjatë. Kërkojini Perëndisë që të pranojë falenderimet tuaja për bukën, që përfaqëson trupin e Jezusit, dhe për sakrificën e Tij të madhe. Më pas, kalojani bukën çdo kristiani të pranishëm, që ta marrë atë dhe të kujtojë trupin e Jezusit.

Pregatitja e bukës për Darkën e Zotit kërkon vetëm pak materiale të zakonshme: miell, ujë, kripë dhe vaj. *Mos* i hidhni maja brumit. Këtu është një recetë për të pjekur dy bukë të vogla në masën e dorës tuaj.

#### Materialet:

1 gotë miell (250 mg)

3 lugë çaji vaj

1 lugë çaji ujë

pak kripë

#### Udhëzimet:

Përziejini materialet e mësipërme dhe vendoseni brumin në një tepsi të vajosur. Shtresa e hollë e brumit duhet të shpohet dhe pastaj të piqet për rreth 10 minuta në një sobë me temperaturë 175 gradë. Buka e pjekur nuk do të ketë ngjyrë të errët. Brumi gjithashtu mund të piqet mbi një zjarr deri sa të jetë gati.

Së dyti, merrni kupën ose kupat të cilat mbajnë frutin e vreshtit. Lutjuni Perëndisë, duke e falenderuar për gjakun e shtrenjtë që Jezusi derdhi për faljen e mëkateve tona. Pas lutjes, kalojani kupën apo enën me kupat kristianëve që janë të pranishëm, kështu që secili të mund të pijë nga fruti i vreshtit në përkujtim të gjakut të Jezusit të derdhur për ne.

Kur Jezusi urdhëroi darkën, Ai përdori «frutin e

vreshtit». Ai gjendet gati kudo në botë. Sidoqoftë, në qoftë se nuk mund të blihet në zonën tuaj, ai mund të prodhohet duke shtrydhur rrushin në një enë. Në qoftë se lëngu i shtrydhur gjatë sezonit të vjeljes së rrushit është ruajtur në mënyrën e duhur, ai mund të përdoret gjatë gjithë vitit. Fruti i vreshtit gjithashtu mund të merret duke zier rrush të thatë në ujë. Pasi të jetë hequr rrushi i thatë, lëngu që ka mbetur mund të përdoret për Darkën e Zotit.

### **Të vënit mënjanë apo të dhënë**

Çdo kristian duhet të «vendosë mënjanë dhe të kursejë nga të ardhurat e tij» me qëllim që të ndihmojë punën e kishës në punën e Perëndisë. Në një moment të caktuar, gjatë kohës që kisha është mbledhur për të adhuruar Perëndinë, çdo kristiani duhet t'i jepet mundësia për të dhënë sipas të ardhurave të tij, ashtu si na mëson Testamenti i Ri (1 Korintasve 16:1–2). Ndonjë qese apo shportë mund të kalojë dorë më dorë për të grumbulluar kontributet, ose ndonjë vend mund të përgatitet ku kristianët mund të lenë paratë apo dhuratat të cilat ata i kanë hequr mënjanë për Perëndinë. Mbani mend se kjo është një vepër nderimi dhe duhet bërë me respekt dhe me gëzim. Dhuratat e dhëna duhet të përdoren për të bërë punën e kishës. Për shembull, dhuratat e mbledhura mund të përdoren për të shpërndarë Fjalën e Perëndisë ndër njerëzit e tjerë, për të ndihmuar të varfërit, për të blerë Bibla për studim apo për çdo qëllim tjetër që mund të jetë në harmoni me punën e kishës. Vendimet se si duhet të përdoren të hollat e mbledhura nga dhuratat e anëtarëve të bashkësisë, duhen marrë nga bashkërisht dhe jo nga një individ i vetëm.

Kohën e adhurimit në bashkësi mund ta organizoni në këtë mënyrë:

Lutje  
Këngë

Këngë

Një diskutim i një kapitulli nga Shkrimet apo një predikim  
n.q.s. një mësues i aftë apo predikues është i gatshëm

Këngë

Lexim nga Shkrimet për Darkën e Zotit

Marrja e Darkës së Zotit

Këngë

Dhënia e kontributit

Kënga

Lutja e mbylljes

Kjo mënyrë organizimi është vetëm një sugjerim. Ajo nuk është e detyrueshme për çdo bashkësi. Këtu kemi parasysh radhën sipas të cilës kryhen veprimet dhe jo faktin nëse një apo më shumë nga veprimet e nderimit të përmendura duhen përfshirë në adhurimin në bashkësi apo jo.

### **Drejtimi i takimeve të bashkësisë**

Me qëllim që bashkësia lokale të drejtojë punën e saj «ashtu siç ka hije dhe me rregullsi», (1 Korintasve 14:40), burrat e bashkësisë duhet të takohen herë pas here. Në mënyrë të veçantë kjo është e rëndësishme, në se kisha nuk ka më të vjetër (pleq) për ta drejtuar. Këto takime nuk do të kenë për qëllim krijimin e ligjeve në emër të Perëndisë, por të sigurojnë se nderimi dhe puna e bashkësisë është bërë në mënyrën kristiane, sipas mësimave të Perëndisë. Në këto takime mund të merren vendime për organizimin e kohës së adhurimit në bashkësi, mund të bëhet ndarja e detyrave individuale për ata që do të drejtojnë këngët, lutjet, Darkën e Zotit, predikimin e të tjera si këto të lidhura me adhurimin e Perëndisë në bashkësi. Në këto takime mund të diskutohet dhe të merren vendime për punët e mira që kisha duhet të bëjë sipas udhëzimeve të Perëndisë apo mund të diskutohet për mbarëvajtjen shpirtërore të anëtarëve të bashkësisë. Është e rëndësishme që çdo njeri që merr pjesë në një takim të tillë, të sillet në mënyrë kristiane (Efesianëve 4:1–3).

Dikush ka thënë: «Secili ka të drejtë të shprehet, por asnjë nuk ka të drejtë të mendojë se vetëm mendimi i tij duhet ndjekur.» Kjo është një shprehje e mirë.

Kur diskutohen çështjet e bashkësisë, për çdo vendim të marrë duhet të bëhen këto pyetje:

- A përputhet me Shkrimet?
- A i sjell lavdi Perëndisë?
- A do ta ndihmojë kishën?
- A do të japë rezultat?

Burrat duhet të bien dakort për shpeshhtësinë dhe kohën e këtyre takimeve. Ata duhet të zgjedhin një kohë të përshtatshme për shumicën e burrave. Një nga vëllezërit e pjekur kristianë duhet zgjedhur për të udhëhequr takimet. Është mirë që ky person që ka këtë përgjegjësi, të ndërrohet herë pas here. Kjo nuk është një pozitë autoriteti, por është thjesht një rrugë që lehtëson punën në këto takime. Vendimet e marra duhet të përfaqësojnë konsensusin e burrave. Dikush duhet të mbajë shënim diskutimet e bëra. Një takim i tillë mund të ndjekë këtë rregull:

Lutje

Diskutimi i problemeve të vjetra – diskutimi i lënë i papërfunduar nga takimet e kaluara, raportimi për progresin në kryerjen e detyrave të lëna më parë, raportim personal i çdo personi i cili kishte marrë përsipër një detyrë të veçantë

Diskutimi i problemeve të reja që kanë dalë – shqyrtimi i nevojave dhe planifikimi për përmbushjen e tyre në të ardhmen, ndarja e detyrave për secilin në të ardhmen dhe diskutimi i shqetësimeve që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen shpirtërore të bashkësisë

Lutje

### **Adhurimi i Perëndisë çdo ditë**

Ju do të doni ta nderoni Perëndinë çdo ditë në zemrën tuaj dhe bashkë me ju, edhe familja juaj fizike. Lutjuni

Perëndisë për çdo vakt që hani, duke i dhënë falenderime për ushqimin që Ai ju ka dhënë, përpara se të filloni të hani. Lutuni rregullisht me familjen tuaj, duke i sjellë përpara Perëndisë nevojat që keni dhe duke i dhënë falenderime dhe nderime për gjithçka që Ai ka bërë për ju.

Natyrisht, ju do të doni ta nderoni Perëndinë, përveç të dielave, edhe ditët e tjera të javës. Ju duhet të takoheni gjithmonë të dielën, duke përfshirë në atë shërbesë nderimi marrjen e Darkës së Zotit dhe kontributin. Përveç asaj, ju ndoshta do të doni të takoheni me vëllezërit tuaj kristianë edhe gjatë ditëve të tjera të javës, në kohë që do të jenë të përshtatshme për ju. Gjatë këtyre takimeve mund të studioni Biblën, të luteni apo t'i këndonit Perëndisë. Është e rëndësishme për kristianët të takohen shpesh së bashku, të nderojnë së bashku dhe të inkurajojnë njëri-tjetrin në Zotin.

Si shërbëtor i Perëndisë, ju duhet ta lini Atë t'ju flasë përditë duke lexuar dhe studiuar Fjalën e Tij. Ju gjithashtu mund të flisni me Të përditë, me anë të lutjeve tuaja drejtuar Atij.

## **HAPI I KATËRT: KRYERJA E PUNËVE TË MIRA**

Hapi i katërt që keni nevojë të bëni është t'i shërbeni Perëndisë. Tani jeni kristianë, ndjekës të Krishtit, kështu jetoni duke pasur jetën e Tij në tokë si model. Në Bibël na është treguar se Ai gjithnjë bëri punë të mira (Veprat 10:38).

### **Shpërndarja e Ungjillit**

Kristianët duhet ta shpërndajnë ungjillin në njerëzit e tjerë. Jezusi na urdhëroi përpara se të rikthehej në qiell: «Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijesë...» (Marku 16:15). Krishti vdiq për të krijuar ungjillin. Është detyra e çdo kristiani të kontribuojë në shpërndarjen e ungjillit në të gjithë njerëzit. Një nga mënyrat



për ta shpërndarë ungjillin ndër njerëzit e tjerë është t'u kërkonti njerëzve që njihni, të lexojnë këtë libër. Mund të filloni ta bëni këtë me pjesëtarët e familjes tuaj apo me miqtë tuaj më të ngushtë. Pasi të kenë përfunduar leximin, i inkurajoni ata që të bëhen kristianë. Le të bëjmë gjithçka që mundemi për t'i sjellë të tjerët te Krishti dhe te shpëtimi i ofruar nga Perëndia nëpërmjet Tij.

### **Ndërtimi i të tjerëve**

Një detyrë tjetër e kristianëve është të ndërtojnë të tjerët. Fjala «ndërtoj» nënkupton të ndihmosh anëtarët e bashkësisë në procesin e rritjes së tyre shpirtërore. Kur bashkësia juaj të ketë pesëmbëdhjetë apo më shumë anëtarë, ju lutemi na shkruani te «Truth for today, Shkolla e misionit botëror» (adresa: 2209 S. Benton, Searcy, AR 72143 USA) dhe ne do t'ju dërgojmë materiale për t'ju ndihmuar në studimin e Biblës. Le të vazhdojmë ta njohim Krishtin dhe rrugën e Tij gjithnjë e më shumë dhe le t'i inkurajojmë të tjerët, që të rriten bashkë me ne në këtë proces.

### **Ndihma për të tjerët**

Ju gjithashtu do të doni të bëni punë të mira. Pyesni veten: «Çfarë mund të bëj për të ndihmuar të varfërit?» Ju nuk mund të jeni si Krishti, të jeni një ndjekës i Tij, dhe, në të njëjtën kohë, të mos kujdeseni për nevojtarët (Mateu 25:31–46).

Ja një listë e disa prej punëve të mira të kristianëve:

U mësojnë të tjerëve ungjillin.

Vizitojnë të sëmurët.

Ndihmojnë fëmijët për të mësuar për Perëndinë.

Punojnë për të mbajtur lagjet e tyre të painfluencuara nga e keqja.

Drejtojnë studime Bible për rritjen shpirtërore të anëtarëve të bashkësisë.

Ushqejnë të uriturit.

Ndihmojnë të vejat dhe jetimët.  
 U bëjnë vizita të burgosurve.  
 Praktikojnë mikpritjen.  
 Shpërndajnë literaturë kristiane.  
 Ftojnë të tjerët në takimet e bashkësisë.  
 Lutën për të tjerët.  
 Lexojnë Biblën për ata që s'mund të lexojnë.

Jezusi erdhi në këtë botë për të shërbyer. Ai nuk erdhi që të tjerët të kujdeseshin për Të, por erdhi për t'u kujdesur për të tjerët dhe për të dhënë jetën e Tij si sakrificë për shumë të tjerë (Marku 10:45). Ne nuk mund të vdesim për të tjerët ashtu si vdiq Jezusi, por mund të jetojmë për të tjerët duke u mësuar atyre ungjillin, duke i ndihmuar ata që të rriten në Krisht, duke treguar dhembshuri, kur ata kanë probleme dhe duke i ndihmuar në zgjidhjen e këtyre problemeve.

### KONKLZIONI

Këto janë pra hapat që duhet të bëni për t'u bërë kristianë dhe për të jetuar si të tillë: Kthehuni te Krishti, filloni të jetoni për Të, filloni ta nderoni Atë rregullisht dhe filloni t'u shërbeni të tjerëve në emrin e Tij.

A e keni lexuar tregimin e fisnikut Etiopas te Veprat 8? Në qoftë se nuk e keni lexuar, ndalojeni leximin e këtij libri dhe lexojeni atë tregim tani. Filipi u dërgua për t'i mësuar Etiopasit ungjillin. Me gëzim, Etiopasi e pranoi ungjillin dhe u bë kristian. Pastaj, po aq papritur sa u shfaq, Filipi u largua për në një vend tjetër.

Filipi ishte një njeri i frymëzuar. Libri që po lexoni, nuk është i frymëzuar (përveç pjesës së fundit, Testamentit të Ri). Sidoqoftë, në këto faqe, ju keni lexuar se çfarë na mëson Testamenti i Ri për shpëtimin që Krishti solli dhe për kishën që Ai themeloi. Pra, këto faqe ju kanë drejtuar për nga libri i frymëzuar, Bibla. Krahasojeni përmbajtjen e këtij libri me të vërtetat e Biblës dhe do të shikoni se ne

jemi përpjekur t' u përmbahemi mësimëve të Testamentit të Ri.

Ashtu si Filipi u largua, edhe ne duhet ta mbyllim këtë studim. Unë nuk e di çfarë ndodhi me burrin Etiopas. Bibla nuk na tregon ndonjë gjë për këtë. A shkoi në Etiopi për të jetuar, nderuar dhe shërbyer si kisha e Perëndisë? Bindja ime është se ai bëri pikërisht kështu.

Perëndia i dha Etiopasit një mundësi për të shpëtuar. Nuk ishte një studim i gjatë ose i vështirë, por ishte i mjaftueshëm për t' i mësuar atij si të bëhej kristian dhe si të jetonte si kristian. Ne jemi përpjekur t' ju japim të njëjtën mësim edhe ju. Mundësia tani është juaja. Ne dëshirojmë që ju të përfitoni sa më shumë nga kjo mundësi. Ne ju themi tani një lamtumirë të singertë. Dëshirojmë që bekimet e panumërta të Perëndisë të vijnë mbi ju, ndërsa i bindeni ungjillit që Ai e ka dhënë përmes Birit të Tij. Ne do të presim me padurim që t' ju takojmë në qiell, në qoftë se nuk ju takojmë më parë.

## SHËNIME

<sup>1</sup>Në shekullin e parë pas Krishtit, e diela konsiderohej si dita e parë e javës (jo e hëna). E njëjta gjë ndodh edhe sot në shumë shtete të botës si p.sh. në SHBA.

<sup>2</sup>Organizimi i kishave të Testamentit të Ri ishte i thjeshtë dhe i bazuar në modelin e dhënë nga Perëndia. E para, kishte predikues dhe mësues që predikuan dhe shpërndarë Fjalën. E dyta, çdo bashkësi që kishte arritur një pjekuri të mjaftueshme, kishte një numër më të vjetërsh (disa herë janë quajtur «mbikëqyrës», «barinj» dhe «pastor») të cilët udhëhiqnin bashkësinë dhe kujdeseshin për mbarëvajtjen shpirtërore të çdo anëtari. E treta, çdo bashkësi kishte dhjakë, të cilët i shërbyen kishës nën mbikqyrjen e më të vjetërve.

<sup>3</sup>Testamenti i Ri emëron vetëm një drejtues për kishën: Krishtin. Kisha e Tij nuk ka qendra drejtimi tokësore. Çdo bashkësi kristianësh duhet të ndjekë vetëm udhëheqjen e Krishtit.

**PËRGJIGJUNI PYETJEVE**

*(përgjigjet në mësimin “Shtojca 1”)*

1. Pse pyetja «Çfarë do të bësh me Jezusin?» ka pasoja për përjetësinë?
2. A duhet të pagëzohen foshnjat dhe fëmijët e vegjël? Cilat janë arsytet?
3. Cili është qëllimi i pagëzimit?
4. Cilat janë disa nga pyetjet që do t’ju ndihmojnë për të gjetur kishën e Krishtit?
5. Ku gjendet në Shkrimet se pagëzimi është varrosje në ujë?
6. Cila është mënyra më e mirë për të përmbledhur jetën e një kristiani?
7. Pse duhet që një kristian të qëndrojë afër Fjalës së Perëndisë?
8. Çdo të diel kisha do të takohet të nderojë Perëndinë. Si mund të bëhet ky nderim praktikisht?
9. Cilët janë dy elementët që Jezusi përdori kur themeloi Darkën e Zotit?
10. Cilët janë katër hapat që duhet të merrni, me qëllim që të bëheni kristian dhe të jetoni si i tillë?

Autor: *Eddi Cloer*

Marrë nga libri: *“Si të bëhesh një kristian besnik”*

© 2002 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara